



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-CC-PR-2017-03

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 31 maj 2017

**Titulli:** Referimi i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së  
Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19 (5) të Ligjit

**PUBLIK**

**me SHTOJCA KONFIDENCIALE**

---

**REFERIM**

**i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe Provave,  
Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese**

---

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të nenit 19(5) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), me anë të këtij vendimi i referon Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“DHSGJK”) Rregullat e Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullat e Rishikuara”), si më poshtë:

- i. Rregulla 19;
- ii. Rregullat 30-39, 41 [më parë rregullat 30-36, 38];
- iii. Rregulla 57 [më parë rregulla 54];
- iv. Rregulla 137 [më parë rregulla 134];
- v. Rregulla 161 [më parë rregulla 158].

1. Më 17 mars 2017, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare (“Plenarja”), me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”). Më 27 mars 2017, në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit, Kryetarja i referoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese Rregulloren e miratuar, për të garantuar përputhshmërinë e saj me Kapitullin II, duke përfshirë nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Kushtetuta”).<sup>1</sup>

2. Më 26 prill 2017, DHSGJK-ja nxori “Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar” (“Aktvendimi”). DHSGJK-ja konstatoi se nëntë rregulla nuk ishin në përputhje me Kapitullin II të

---

<sup>1</sup> Referim i Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Nr. KSC-CC-PR-2017-01, 27 mars 2017.

Kushtetutës, dhe për një rregull tjetër nuk mund të nxirrte konstatim mbi përputhshmërinë.<sup>2</sup>

3. Kryetarja përgatiti versionin e parë të Rregullave të Rishikuara duke mbajtur parasysh konstatimet dhe arsyetimin në Aktvendim, si edhe jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut. Më 12 maj 2017, ky version iu shpërnda të gjithë gjykatësve për shqyrtim. Më 17 maj 2017, të gjithë gjykatësit dorëzuan vërejtjet e tyre në lidhje me këtë version të cilat u analizuan dhe diskutuan individualisht me secilin prej tyre. Më 26 maj 2017, gjykatësve iu dorëzua një version i dytë i përditësuar për vlerësim dhe votim përfundimtar. Më 29 maj 2017, Rregullat e Rishikuara u miratuan me votim përmes mjeteve të komunikimit.

4. Shtojca I e këtij parashtrimi përmban Rregullat e Rishikuara në formën e miratuar më 29 maj 2017, së bashku me shënime të shkurtra shpjeguese në lidhje me secilën rregull ku pasqyrohen paragrafët përkatës të Aktvendimit dhe rregulla e rishikuar përkatëse. Në qoftë se dëshiron, DHSGJK-ja mund ta përdorë këtë dokument për ta ndihmuar në punën e vet.

5. Së fundi, këtij parashtrimi i bashkëngjitet si Shtojca II versioni i përditësuar i gjithë Rregullores në të cilin pasqyrohen:

- a. korrigjimet thelbësore të kryera si rrjedhojë e Aktvendimit në lidhje me Rregullat e Rishikuara, si edhe
- b. korrigjime gabimesh të vogla shtypi të hasura në Rregulloren e miratuar më 17 mars 2017.

6. Shtojcat I dhe II parashtrihen konfidencialisht për hir të privatësisë së kuvendimeve të panelit të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, klasifikimi konfidencial është i përshtatshëm duke qenë se Rregullorja ende nuk ka hyrë në fuqi dhe përmbajtja e saj në formën e miratuar më 29 maj 2017 në disa aspekte ndryshon prej

---

<sup>2</sup> Aktvendimi, para. 215-216.

tekstit të miratuar më 17 mars 2017. Versioni publik i Rregullores do të mundësohet pas vendimit të DHSGJK-së.

**PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA**, dhe në përmbushje të përgjegjesisë së vet për administrimin gjyqësor të Dhomave të Specializuara në bazë të nenit 32(3) të Ligjit,

**NË VIJIM, KRYETARJA**

**referon** për shqyrtim Rregullat e Rishikuara që i bashkëngjiten Shtojcës Konfidenciale I, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me Kapitullin II, duke përfshirë edhe nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E mërkurë, 31 maj 2017

Në Hagë, Holandë.